



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PORTUAL Durrës
DIVIZIONI JURIDIK**

Nr. _____ Prot.

Durrës, më ____/____/2021

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data 26.11.2021]

Drejtuar: “SENKA” SHPK;
Adresa: Xhevdet Nepravishta, Lushnje.

Procedura e prokurimit/lotit: “Hapur e Thjeshtuar”.
Numri i procedurës/referenca e Lotit: REF-04481-09-02-2021.
Përshkrimi i shkurtër i kontratës:
- “Zbatimi Projektit "Rehabilitimi i zonës së ish peshkimit””.
Kohëzgjatja e kontratës: 60 (gjashtëdhjetë) ditë.
Buletini i Njoftimeve Publike: 07.09.2021, Nr. 132.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:
oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto
oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. “EUROVIA shpknj” SHPK, me NIPT L91426009G;
 - Oferta, në vlerën 5.615.221,71 (pesë milion e gjashtëqind e pesëmbëdhjetë mijë e dyqind e njëzet e një/presje shtatëdhjetë e një) lekë, pa TVSH.
2. “AVDULI” SHPK, me NIPT J66703306O;
 - Oferta, në vlerën 7.095.359 (shtatë milion e nëntëdhjetë e pesë mijë e treqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë, pa TVSH.
3. “SENKA” SHPK, me NIPT J94808405Q;
 - Oferta, në vlerën 6.520.490 (gjashtë milion e pesëqind e njëzet mijë e katërqind e nëntëdhjetë) lekë, pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit është skualifikuar Ofertuesi i mëposhtëm:

- “EUROVIA shpknj” SHPK, me NIPT L91426009G, për arsyet e mëposhtme:

1. Referuar deklaratës në piken II.A. të shtojcës 8: *“Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së”*,

- Nuk është paraqitur asnjë vertetim nga gjykata apo institucion tjetër që provon vertetesinë e këtij deklarami. Vertetimet duhet të ishin leshuar për të dyja subjektet si për subjektin mëmë dhe degen e saj në Shqipëri.

2. Referuar deklaratës në piken II.A. të shtojcës 8: *“Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: --- etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.”*,

Per personat përfaqësues të deklaruar:

Emir Shefiti, Administrator;

Elmedin Ademi, Ortak;

Sebastjan Skenderi, Përfaqësues me Prokurë;

Orea Mullaymeri, përfaqësues me Prokurë,

- Nuk janë paraqitur dëshmi penaliteti dhe vertetim nga drejtoria e burgjeve apo institucion tjetër që provon vertetesinë e këtij deklarami.

3. Referuar deklaratës në piken II.A. të shtojcës 8: *“Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale”*,

- Nuk është paraqitur vertetim nga gjykata apo institucion tjetër që provon vertetesinë e këtij deklarami. Vertetimet duhet të ishin të leshuara për të dyja subjektet si për subjektin mëmë dhe degen e saj.

4. Referuar kërkesës *“Operatori ekonomik duhet të paraqesi një dëshmi nga administrata tatimore për punësimin mesatar jo më pak se 15 punonjës për periudhën Maj 2021 – Korrik 2021, ku përfshihen edhe stafi menaxherial i drejtuesve teknik. Kjo të dëshmohet me Vertetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën e sipërpermendur e të shoqërohet me list-pagesat e plotësuara rregullisht sipas formularit të përcaktuar E-SIG 025/a dhe formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore, shendetësore.”*,

- Është paraqitur Liste pagese kontributësh leshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore, Tirane, për muajt qershor, korrik, gusht 2021, për degen e kompanisë në Tirane. Për kompaninë mëmë në Republikën e Maqedonisë Veriore, është paraqitur liste pagesa për muajt korrik, gusht 2021 leshuar nga kjo kompani.

Për kompaninë mëmë, nuk janë paraqitur listepagesa për tre muajt e fundit leshuar nga organ tatimor zyrtar në vendin që subjekti mëmë operon.

5. Referuar shkresës nr. 3688 prot, date 02. 11. 2021 për dorezimin e dokumentacionit nuk janë paraqitur CV-te për pjestarët e stafit: Ing. Kostandinos Servini, Ing. Nazmi Tahiri, Ing. Elida Stermilli, Ing. Esida Lekbello.

6. Për kamionin me targa AA561DS, të deklaruar në shtojcën 8, në dokumentacionin e dorezuar me shkresën nr. 3688 prot, date 02. 11. 2021, referuar kontratës së qerases nr. Rep

992, nr kol. 514, ne lejen e qarkullimit te noterizuar, eshte mbuluar faqja ku jane te dhenat mbi tonazhin e mjetit.

- Nuk provohet qe kamioni eshte deri ne 20 ton, sipas kerkeses ne kriteret teknike. Gjithashtu mungon siguracioni i mjetit. Eshte paraqitur siguracioni per mjet CATERPILAR dhe jo per kamionin me targa AA561DS.

7. Kamioni me targa LU5764, te deklaruar ne shtojcen 8 dhe sipas dokumentacionit te dorezuar me shkresen nr. 3688 prot, referuar kontrates se qerases nr. Rep 1018, nr kol 527, eshte me i madh se 20 ton, dhe jo sipas kerkeses ne kriteret teknike deri ne 20 ton.

8. Kamioni me targa AA369BZ, te deklaruar ne shtojcen 8 dhe sipas dokumentacionit te dorezuar me shkresen nr. 3688 prot, referuar kontrates se qerases nr. Rep 986, nr kol 511, eshte me i madh se 20 ton, dhe jo sipas kerkeses ne kriteret teknike deri ne 20 ton.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik, shoqërinë “SENKA” SHPK, me adresë: Xhevdet Nepravishta, Lushnje, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 6.520.490 (gjashtë milion e pesëqind e njëzet mijë e katërqind e nëntëdhjetë) lekë, pa TVSH, është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Pirro Vengu